



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/212

Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në konsultim me Presidenten e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Data 11 korrik, shpallet Ditë Memoriale në shenjë të Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë.
- Obligohen institucionet kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2024

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2024, si në vijim:
 - 1.1. Shtohen në Programin Legjislativ për vitin 2024, projektligjet si në vijim:
 - 1.1.1. Projektligji për Agjencinë për Integrim Evropian (ZKM), afati i miratimit 15 dhjetor 2024; dhe
 - 1.1.2. Projektligji për Zejtarinë (MINT), afati i miratimit 30 tetor 2024.
 - 1.2. Tërhiqen nga Programi Legjislativ për vitin 2024, Projektligjet si në vijim:
 - 1.2.1. Projektligji për Mbrojtjen e Individëve ne Lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ZKM); dhe
 - 1.2.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat (MD).
 - 1.3. Ndryshohet afati për miratim në Qeveri i projektligjeve të cilat janë pjesë e Programit Legjislativ për vitin 2024, si në vijim:
 - 1.3.1. Projekt Kodi i Procedurës Civile (MD), afati i miratimit: 20 dhjetor 2024; dhe
 - 1.3.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (MD), afati i miratimit: 20 dhjetor 2024.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 13 dhe 14 të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi i Statistikave Zyrtare për vitin 2024-2028.
2. Për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi, obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës dhe institucionet tjera prodhuese të statistikave.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës dhe institucionet tjera që prodhojnë statistika zyrtare që pjesën e implikimeve financiare të këtij Programi ta harmonizojnë çdo vit me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, sipas viteve pasuese, nga viti 2024-2028.
4. Programi nga pika 1. e këtij Vendimi publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Bordit Mbikëqyrës "Trepça" Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Mentor Berisha, Kryesues, kryesues;
 - 1.2. Z. Fadil Bejta, anëtar;
 - 1.3. Z. Alban Krasniqi, anëtar;
 - 1.4. Znj. Merita Gashi, anëtare;
 - 1.5. Znj. Sadije Gashi, anëtare.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën dhe Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009.
3. Mandati i të emëruarve zgjatë katër (4) vite.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, në këtë përbërje:
 - Z. Naim Gashi, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, kryesues;
 - Z. Ilir Muçaj, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
 - Znj. Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare;
 - Znj. Jehona Murati-Dugolli, Udhëheqëse e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, anëtare; dhe
 - Z. Vehbi Ramaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

- Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i Projektit : Konservimi, Restaurimi dhe Ndërtimi i Kompleksit Memorial "Masakra e Reçaku" ZK Reçak, Komuna e Shtimes, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
- Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
- Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
- Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK).
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

- Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9 Kijevë-Zahaq, Segmenti Dollc-Ramun, Zonat Kadastrale: Dollc, Zajm, Grabanicë, Drenoc, Pjetërq i Epërm dhe Pjetërq i Poshtëm, Komuna Klinë dhe Zonat Kadastrale: Jabllanicë, Kliçinë, Leshan, Gllaviçicë dhe Ramun të Komunës së Pejës, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
- Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
- Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
- Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

- Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Ndërtimi i Rrugës Rajonale R221 Cerkoz-Rakosh, Zonat Kadastrale: Cerkoz, Rakosh, Suhogërlle dhe Uçë, Komuna Istog, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
- Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
- Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
- Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 21, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1 dhe paragrafit 2. të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/104, të datës 10 gusht 2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/26, të datës 23 prill 2020, Vendimin Nr. 02/12, të datës 21 maj 2021, Vendimin Nr. 11/28, të datës 28 gusht 2022, Vendimin Nr. 09/121, të datës 25 janar 2023, dhe Vendimin Nr.02/197, të datës 29 mars 2024

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.1 e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/121, të datës 25 janar 2023 si në vijim:
 - 1.1 "Rrustem Thaqi - Kryetar i Komisionit".
2. Kryetari i Komisionit nga pika 1. e këtij Vendimi. obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e tij, t'i kryej në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 10/104, të datës 10 gusht 2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/26, të datës 23 prill 2020, Vendimin Nr. 02/12, të datës 21 maj 2021, Vendimin Nr. 11/28, të datës 28 gusht 2022, Vendimin Nr. 09/121, të datës 25 janar 2023, dhe Vendimin Nr.02/197, të datës 29 mars 2024.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka nxjerr Vendimin Nr. 187/2024, të datës 25.06.2024, me të cilin ka propozuar z. Rrustem Thaqi, gjyqtar në Gjykatën Supreme, për kryetar të Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Ky Vendim derivon nga neni 21 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe paragrafi 2) i Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, për faktin se ish Kryetari i këtij Komisioni z. Zenel Leku, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë për shkak të zgjedhjes si Kryetar i Panelit për Ankesa dhe Parashtresa.

Andaj, duke pas për bazë të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9, paragrafit 3. të Ligjit Nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.06/106 i datës 9 nëntor 2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 21/16 të datës 22 qershor 2021 për formimin e Grupit Punues Ndërmintor për koordinimin e punës së të gjitha ministrive kompetente në lidhje me legjislacionin teknik, i cili është përgjegjës për zbatimin e detyrave që dalin nga lëvizja e lirë e mallrave në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Kosovës.
2. Paragrafi 2. i Vendimit Nr.06/106 të datës 9 nëntor 2022 ndryshohet si në vijim:
 - 2.1. Albana Krasniqi, zëvendësohet me Liridona Hoti, anëtare;
 - 2.2. Lendita Sopa, zëvendësohet me Florije Tahiri, anëtare; dhe
 - 2.3. Driton Ademi, zëvendësohet me Destan Mustafa, anëtar.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 21/16 të datës 22 qershor 2021 dhe Vendimit Nr.06/106 të datës 9 nëntor 2022.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në pajtim me nenin 62 paragrafi 1. dhe nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Ministror për Zhvillimin e Kornizës për Integrimin e Komuniteteve jo shumicë në Administratën Publike të Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, kryesues;
 - 1.2. Ministri i Ministrisë të Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 1.3. Ministri i Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
 - 1.4. Ministri i Ministrisë të Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar.
2. Komisioni nga paragrafi 1. i këtij Vendimi ka për obligim t'i propozojë Qeverisë së Republikës së Kosovës rekomandime mbi zbatimin e ligjeve ekzistuese por edhe hartimin e politikave të nevojshme për qëllim përfshirjen e komuniteteve jo shumicë brenda administratës publike.
3. Komisioni mund të ftojë anëtarë të tjerë të kabineteve politike, zyrtarë të administratës publike, ekspertë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile e institucioneve partnere, sipas nevojës, të marrin pjesë në takimet e Komisionit.
4. Ministria për Komunitete dhe Kthim kryen funksionin e Sekretariatit teknik të këtij Komisioni.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/212
Datë: 10.07.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, neneve 10 deri në 22 të Ligjit Nr.08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet fillimi i procedurave të tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga era dhe për dhënien e mbështetjes për këto kapacitete deri në 150 megavat. Këto procedura do të zhvillohen në dy procedura tenderimi të ndara.
2. Procedurat e tenderimit të autorizuara nga Qeveria e Republikës sipas pikës 1. të këtij Vendimi, zhvillohen nga Ministria e Ekonomisë sipas Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat dhe Ligjit Nr.08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji sipas detyrës zyrtare do të shërbejë si anëtar në Komitetin për Partneritete Publiko Privat dhe do të përfaqësohet nga Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së.
4. Ministria e Ekonomisë përfaqëson Autoritetin Kontraktues sipas Ligjit për Partneritet Publiko Privat dhe ka për obligim projektimin, dizajnin dhe zbatimin e procedurave të tenderimit të kapaciteteve gjeneruese në përputhje me ligjet në fuqi dhe vendimet e Komitetit për Partneritete Publiko Privat/KPPP.
5. Ministria e Ekonomisë autorizohet të përfshijë në dokumentacionin e tenderimit, rregullat për trajtimin e ofertave me kapacitet prej 150 megavat apo mund të tejkalojë kapacitetin specifik, në përputhje me praktikën më të mira të industrisë, të vendosura dhe në konsultim me Rregullatorin e Energjisë, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.
6. Të gjitha procedurat e tenderimit do të projektohen në bazë të kriterëve objektive, transparente dhe jo diskriminuese dhe do të zbatohen në përputhje të plotë me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Partneritet Publiko Privat dhe Ligjit Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30 paragrafit 2. të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, nenit 12 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, në përputhje me Vendimin e Qeverisë Nr. 06/134 të datës 1 mars 2017, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 06/121 të datës 25 janar 2023

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/121 të datës 25 janar 2023, dhe shtohet nën-paragraf 1.1 si në vijim:
 - 1.1. Ministrisë së Ekonomisë i zgjatet afati për periudhë shtesë prej katër (4) viteve i së drejtës së shfrytëzimit të pronave nga Shtojca 1. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.06/121 të datës 25 janar 2023. Kjo periudhë është e nevojshme për mbulimin e periudhës së kaluar në procesin e ofertimit konkurrues dhe periudhën për ndërtimin e parkut solar 100 MW.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht Agjencia e Pyjeve të Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m


Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 25 janar 2023 ka marrë vendim (Vendimi Nr. 06/121) që nëntë (9) parcela pronë publike që ndodhen në Komunën e Rahovecit (Zona Kadastrale Kramovik dhe Petroviç) të barten tek Ministria e Ekonomisë me të drejtë të shfrytëzimit për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare. Bartja e të drejtës së shfrytëzimit tek Ministria e Ekonomisë është bërë me qëllim që Ministria e Ekonomisë të jap me qira pronën publike në shfrytëzim te investitori i përzgjedhur si ofertuesi më i favorshëm për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në burime të ripërtërishme përmes një procesi të hapur konkurrues-ankand.

Ministria e Ekonomisë ka shpallur shprehjen e interesit për procesin e ofertimit konkurrues-ankandit me datë 12 maj 2023, me datë 13 mars 2023 Ministrisë së Ekonomisë i regjistrohet e drejta e shfrytëzimit të pronës publike nga zyra kadastrale në Komunën e Rahovecit, dhe me datë 16 prill 2024 Ministria e Ekonomisë ka përzgjedhur ofertuesin më të favorshëm nga procesi i ofertimit konkurrues. Me datë 31 maj 2024 Ministria e Ekonomisë ka nënshkruar marrëveshjen për zhvillim të projektit me ofertuesin më të favorshëm për ndërtim të parkut solar me një kapacitet prej 100 MW.

Periodha shtesë prej katër (4) viteve jepet me qëllim për të mbuluar kohën e shpenzuar gjatë procesit të ofertimit konkurrues deri në përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm, duke përfshirë edhe periudhën e nevojshme për ndërtim të parkut solar 100 MW pas përzgjedhjes së ofertuesin më të favorshëm.

Sa për më lartë, ofertuesi më i favorshëm, përkatësisht ofertuesi fitues me çmimin më të ulët të ofruar gjatë procesit të ofertimit konkurrues fiton të drejtën e shfrytëzimit të parcelave nga Aneksi 1 i Vendimit Nr. 06/121 për ndërtim të parkut solar 100 MW nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Qirasë (31 maj 2024). Ofertuesi fitues paguan qira gjatë periudhës së ndërtimit dhe gjatë periudhës tridhjetë (30) vjeçare të operimit, për çka edhe bëhet përshtatja e afatit fillestar.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia e Turizmit e Kosovës 2024-2030 dhe Plani i Veprimit 2024-2026.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafit 1. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja buxhetore në shumë prej 30,000 € (tridhjetë mijë euro) për subvencionim të ndërtimit të shtëpive për komunitetet jo shumicë.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva", dhe transferohen në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën-programin "Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme" me kod 11301, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që përmes një Vendimi të veçantë të bëjë shpërndarjen e mjeteve buxhetore të ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi tek familjet përfituese.
4. Obligohet Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m


Ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale gjatë muajit korrik të vitit 2019 kishte nisur projektin "Ndërtimi i shtëpive-projektet për komunitetet" ku parashihej të ndërtoheshin dyqind e shtatëdhjetë e tre (273) shtëpi për familjet nga komunitetet jo-shumicë për qëllime të banimit social.

Gjatë implementimit të këtij projekti, kontraktori kishte dështuar t'i përmbahet kushteve të kontratës dhe nuk kishte arritur t'i përfundoj shtëpitë e destinuara për komunitetet jo shumicë. Pas shqyrtimit të mundësive për bashkëpunim të mëtutjeshëm për realizimin e projektit, nga mungesa e gatishmërisë së kontraktorit kontrata ishte shkëputur.

Në këtë kontekst, me qëllim të përfundimit të shtëpive të nisura për ndërtim dhe përmbushjes së detyrimit ndaj përfituesve të projektit, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2023 kishte ndarë shumën prej dyqind e nëntëdhjetë mijë euro (290,000.00 €). Mirëpo, për shkak të mungesës së dokumentacionit nga palët, disa përfitues të cilët kanë aplikuar gjatë Thirrjes Publike kishin mbetur të shqyrtohen gjatë këtij viti, dhe si përfundim në mënyrë që të bëhet pagesa për pjesën e mbetur të shpenzimeve për përfundimin e këtyre shtëpive ndahen edhe tridhjetë mijë euro (30,000 €).

Duke u bazuar në sqarimin e mësipërm, u vendos si në dispozitivin e këtij Vendimi

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/212
Datë: 10.07.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 14, paragrafit 2. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 21,070,583.27€ (njëzet e një milion e shtatë dhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre euro e njëzet e shtatë centë) për pagesë sipas Vendimit të Tribunalit të Arbitrazhit për rastin ICC Case No. 26388/HBH Contour Global, LLC vs Republic of Kosova.
2. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga nën-programet si në vijim:
 - 2.1. Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" shuma prej 5,095,583.27€ (pesë milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre euro e njëzet e shtatë cent); dhe
 - 2.2. "Kontigjenca në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve" me kod 28900 kategoria e shpenzimeve "Subvencioneve dhe Transfereve" shuma prej 15,975,000€ (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë euro).
3. Mjetet sipas pikës 1. të këtij Vendimi ndahen në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
4. Autorizohet Thesari që të realizojë transferin e mjeteve buxhetore sipas këtij Vendimi në llogarinë e Contour Global, LLC, sipas udhëzimeve nga Avokatura Shtetërore, në emër të Republikës së Kosovës.
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 28, paragrafit 4. të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Konsoliduar Vjetor për Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Subjektet e Sektorit Publik për vitin 2023.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzoj për informim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/212
Datë: 10.07.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11 paragrafit 7. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Ndahen mjete buxhetore për mbështetje të Këshillit Kombëtar Shqiptar, sipas Memorandumit të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Kombëtar Shqiptar, për ndarjen e 1234 bursave në vlerë prej 731,916.00 € për studentë dhe nxënës në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të përdoren mjetet nga organizata buxhetore Zyra e Kryeministrit me kod 104, nën-programi "Përkrahje për Luginën e Preshevës" me kod 39100, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
- Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi do të transferohen në llogari bankare në emër të Këshillit Kombëtar Shqiptar HALKBANK Iban: RS 35155007040000131481.
- Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë